

Studimi në Finland

Të nderuar lexues

Duke menduar se ka edhe studentë shqiptar të cilët janë të interesuar ti vijojn studimet në ndonjërin nga universitetet finlandeze apo se paku të kenë informacione rreth studimit në Finland jam munduar ta përgatis një broshurë duke sjellur tek ju informacionet e fundit rreth studimit në Finland. Kjo ndoshta nuk është broshura më e mirë rreth kësaj teme por një e veçantë që mund ta konsideroj si pozitive janë informacionet e sakta të bazuara nga institucionet finlandeze. Me anë të kësaj broshure dëshiroj t'ju ofroj studentëve shqiptarë mundësitë më të mira rreth interesimit të tyre për të studiuar në ndonjërin nga universitetet finlandeze. Pasi që Finlanda ka ndër sistemet më të mira të arsimit në botë po shpresoj se edhe kjo broshurë do ju sjell juve informacionet më të nevojshme rreth studimeve në Finland.

Përmbajtja

- Sistemi i arsimit të lartë
- Procedura e pranimit
- Sistemi i pranimit
 - Shkollat politeknike (universitetet e shkencave të aplikuara)
 - Universitetet
- Koha e aplikimit
 - Shkollat politeknike (universitetet e shkencave të aplikuara)
 - Universitetet
- Kriteret e përzgjedhjes në arsimin e lartë
 - Aplikimi për nivelin Bachelor
 - Aplikimi për nivelin Master
 - Informacion të detajuar nga institucionet
- Kërkesat gjuhësore
- Vlerësimi i diplomës
 - Kopjet e certifikatave dhe diplomës
 - Disa pika të rëndësishme për diplomat dhe certifikatat
- Provimet pranuese
- Përzgjedhja e studentëve
 - Çfarë ndodh pas periudhës së aplikimit?
 - Konkurenca dhe vendimi përfundimtar
- Jeta në Finland
 - Para se të arrini
 - Pasi të keni arritur
 - Kostoja e jetesës
- Lidhje të rëndësishme
- Burimet e materialeve

Sistemi i arsimit të lartë

Arsimi i lartë ka një rol të rëndësishëm në shoqërinë finlandeze dhe sistemin kombëtar të inovacionit. Arsimi i lartë e jep një kontribut vendimtar për një shoqëri me njohuri të klasit botëror. Arsimi i lartë finlandez përbëhet nga dy modele

- Shkollat politeknike (njohura edhe si Universitetet e Shkencave të Aplikuara) mirren me nxitjen e arsimit të lartë profesional dhe të aplikuar
- Universitetet mirren me kërkime shkencore dhe të mësuarit artistik.

Shkollat politeknike japin nivele Bachelor (nga 3,5 deri në 4 vjet duke kompletuar 210 – 270 kredi) dhe Master (nga 1 deri në 1.5 vjet duke kompletuar 60 – 90 kredi). Një student në shkollat politeknike ka të drejtë të filloj studimet në nivelin Master pasi ta ketë përfunduar nivelin Bachelor dhe të ketë së paku 3 vjet përvojë pune.

Të gjitha 16 universitetet që veprojnë nën Ministrinë e Arsimit japin nivelet Bachelor, Master, dhe diploma doktorature në sistemin (3 + 2 + 4 vjet). Tek universitetet për të kaluar në nivelin Master nuk kërkohet që të kesh 3 vjet përvojë pune.

Të gjitha studimet janë të kualifikuara me kredi (ECTS, European Credit Transfer System). Për një vit me kohë të plotë studimi përfiton 60 kredi.

Institucionet e arsimit të lartë finlandez japin mbi 340 programe në shkallë universitare të nivelit Bachelor, Master dhe Doktoraturë. Të gjitha këto programe udhëhiqen zyrtarisht nga një gradë (shkallë) e arsimit të lartë finaldeze.

Diplomat e edukimit në anglisht janë në dispozicion në fusha të ndryshme të studimeve.

Universitetet finlandeze zgjedhin studentët e tyre kombëtare dhe ndërkombëtar në mënyrë të pavarur. Provimet pranuese janë një pjesë e rëndësishme e procesit të pranimit. Në sektorin politeknik, studentët finlandez aplikojnë përmes një sistemi kombëtar të aplikimit.

Institucionet e arsimit të lartë finlandez lëshojnë një shtojcë të Diplomës, një dokument i hartuar bashkërisht nga BE-ja, Këshilli i Europës dhe UNESCO-s për të dhënë informacione në lidhje me studimet e përfunduara nga studenti, statusin e shkallës dhe kualifikimin e dhënë ju nevojiten për studime të mëtejshme dhe për punë.

Procedura e pranimit

Pranimi në arsimin e lartë finlandez organizohet nga vetë institucionet arsimore. Kjo do të thotë se, çdo universitet dhe shkollë politeknike në Finlandë zgjedh studentët e vet në mënyrë të pavarur. Me pak fjalë, procedura e pranimit nga fillimi në fund përbëhet nga:

- Zgjedhjen e programit (ve) që ju dëshironi të aplikoni
- Paraqitja e kërkesës tuaj, me certifikatat dhe dokumentet e kërkuara, para afatit të aplikimit
- Duhet hyrë në provimin pranues, në qoftë se kërkohet.
- Pas kësaj, institucionet e arsimit të lartë bëjnë përzgjedhjen përfundimtare të studentëve nga radhët e kandidatëve që plotësojnë kushtet
- Studentët e pranuar pastaj mund të fillojnë organizimin e mbërritjes së tyre në Finlandë.

Në të njëjtën kohë ju mund të aplikoni në 3 vende të ndryshme.

Sistemi i pranimit

Ku të paraqitet kërkesa juaj

Shumica e institucioneve të arsimit të lartë finlandez përdorin sistemin elektronik online të pranimit për të dy nivelet Bachelor dhe Master. Ju gjithashtu do të duhet të dërgoni kopjet e certifikatave tuaj të edukimit të më parshëm dhe dokumentet tjera të kërkuara. Përveç kësaj, në varësi të programit, aplikantët mund të kenë nevojë ti nënshtrohen provimit pranues.

Procedura e aplikimit tek shkollat politeknike dhe universitetet ndryshon prandaj në vijim do i sqarojm veq e veq.

Aplikimi në shkollat politeknike apo universitetet e shkencave të aplikuara

Bachelor:

Për të gjitha programet e nivelit Bachelor duhet përdorur sistemin e përbashkët të aplikimit në www.admissions.fi

Master:

Aplikacionet bëhen direkt tek shkolla politeknike apo universitetet e shkencave të aplikuara por keni kujdes se para se të aplikoni duhet plotësuar kushtin që se paku të keni të kryer nivelin Bachelor dhe tre vjet përvojë pune.

Aplikimi në universitete

Bachelor :

Aplikacionet për programet e nivelit Bachelor bëhen direkt tek institucionet universitare dhe zakonisht universitetet kanë vetëm një afat të aplikimit.

Master:

Aplikacionet për programet e nivelit Master zakonisht bëhen një herë në vit dhe disa nga universitetet e përdorin sistemin e përbashkët www.universityadmissions.fi

Doktoraturë dhe hulumtime:

Aplikacionet për programet e nivelit të doktoraturës dhe hulumtimeve bëhet një herë në vit tek universiteti përkatës. Aplikacionet tek disa universitete kanë kohën e caktuar kur bëhen ndërsa tek disa mund ti bënë në mënyrë të vazhdueshme.

Gjithçka rreth studimeve për doktoraturë dhe hulumtime duhet kontaktuar universitetin përkatës për informacione më të sakta.

Koha e aplikimit

Viti akademik në Finlandë ndahet në dy afate apo semestra:

- Semestri vjeshtor (nga gushti deri dhjetor)
- Semestri pranveror (Janari deri në fund të Majit)

Shumica e programeve studimore fillojnë në fillim të vitit akademik kështu që ju do aplikoni për semestrin vjeshtor ndërsa në disa raste të veqanta është e mundur të aplikohet për studimet që fillojnë në semestrin pranveror.

Aplikimi në shkollat politeknike apo universitetet e shkencave të aplikuara

Pranimi i aplikacioneve për semestrin vjeshtor 2012 për nivelin Bachelor bëhet prej 9 Janar – 14 Shkurt 2012 ndërsa pranimi i aplikacioneve për semestrin pranveror 2012 bëhet gjatë muajve gusht-shtator por të gjitha shkollat politeknike nuk kanë afat për semestrin pranveror prandaj të gjitha informacionet tjera më detajisht mund ti gjeni tek www.admissions.fi

Pranimi i kërkesave për programet Master ndryshon prandaj për më shumë informacione duhet kontaktuar direkt institucionet përkatëse apo disa informacione mund ti gjenie edhe tek www.admissions.fi

Në këto shkolla shumë programe ofrohen në gjuhën angleze.

Aplikimi në universitete

Aplikimi tek universitet siq janë Universiteti i Helsinkut dhe shumë të tjerë dallon pak a shumë nga procedurat që i kanë shkollat politeknike prandaj në vijim do i përmendim disa pika kryesore që janë të nevojshme gjatë aplikimit.

- Koha e sakt dhe periudha e aplikimit mvaret nga institucioni dhe programi që ofrohet.
- Sidoqë të jetë shumica e aplikacioneve për të dy shkallat Bachelor dhe Master fillon ndërmjet muajve Nëntor dhe Janar.
- Për pranim të nivelit Bachelor në universitete duhet kontaktuar direkt universitetin për më shumë informacione, si dhe kur duhet aplikuar sepse në universitete ofrohen më pak programe Bachelor në gjuhën angleze.
- Për pranim të nivelit Master shumica e universiteteve përdorin webfaqen www.universityadmissions.fi ndërsa janë vetëm disa universitete që kërkoja procedura të veqanta të aplikimit.
- Nëse vërtet jeni të interesuar të aplikoni në ndonjërin nga universitetet, shikoni me kujdes aplikacionin e sakt tek zyra e pranimet të universitetit përkatës.

Kriteret e përzgjedhjes në arsimin e lartë

Për t'u konsideruar një aplikacion i pranueshëm për një program të veçantë, ju duhet të përmbushni disa kërkesa. Është shumë e rëndësishme që ju kontrolloni gjithmonë të dhënat e këtyre kërkesave drejtpërdrejtë te institucioni që ju po aplikoni. Nëse për ndonjë arsye ju nuk konsideroheni i përshtatshëm, aplikacioni juaj nuk do të përpunohet.

Në përgjithësi, rregullat bazë të përzgjedhjes janë si më poshtë:

Aplikimi për nivelin Bachelor

Për pranim në nivelin Bachelor ju pritët që:

- Të keni një certifikatat arsimore që të jep të drejtë të aplikoni në arsimin e lartë në vendin tuaj
- Plotësoni kërkesat e aftësive në gjuhën Angleze të përcaktuara nga institucioni pritës
- Kaloni me sukses provimin pranues

Aplikimi për nivelin Master

Nëse vetëm posedoni një diplomë të shkollimit të lartë nga vendi juaj dhe dëshironi të aplikoni në një program Master apo Doktoraturë në Finland, atëherë e dreja juaj vendoset në bazë të

- Nivelit dhe cilësinë së kualifikimit tuaj të mëparshëm
- Aftësitë tuaja gjuhësore dhe kërkesa tjera të mundshme

E kemi përmendur se gjatë aplikimit tek shkollat politeknike në nivelin Master kërkohet që të posedoni përpos nivelit Bachelor edhe tre vjet përvojë pune ndërsa në universitete kjo përvojë nuk kërkohet por në disa raste kërkohen disa kërkesa tjera gjatë procedurës së pranimet.

Për studentët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelor në ndonjërin nga shkollat politeknike në Finland janë disa procedura që pak ndryshojn prandaj për këtë ata të cilët studiojnë në Finland janë të njoftuar rreth këtyre gjërave.

Informacion të detajuar nga institucionet

Pasi e drejta juaj vlerësohet gjithmonë nga institucioni i arsimit të lartë finlandez që po aplikoni, kështu që për informacione të hollësishme për kushtet e studimit për çdo program është mirë që të konsultoheni me faqen e internetit të institucionit në fjalë.

Nëse ju keni dyshime në lidhje me të drejtën tuaj, ju mund të kontaktoni zyrën e pranimeve të institucionit që ofron programin.

Kërkesat gjuhësore

Aftësi në gjuhën angleze

Para se të pranoheni në një program në gjuhën angleze, institucionet e arsimit të lartë kanë nevojë për të siguruar që aftësitë tuaja të gjuhës angleze i plotsojnë kriteret e kërkuara nga institucioni.

Ju duhet ti ndjekni ligjeratat, të shkruani përgjigjet e provimit me shkrim dhe ese, merreni pjesë në diskutimet e grupeve dhe seminareve etj prandaj, ju duhe ti dëshmoni zyrtarisht aftësit tuaja të gjuhës angleze duke dëshmuar:

- rezultatet e një testi të vlefshëm TOEFEL ose IELTS (mund të pranohen edhe teste tjera zyrtare)
- rezultati minimum i testit të kërkuar mund të ndryshojn nga një program në tjetrin.
- disa institucione mund gjithashtu të ofrojnë mënyra tjera të kontrollimit të aftësive tuaja gjuhësore psh duke u lidhur me provimin pranues.

Nëse ju keni kryer shkollën tuaj të mëparshëm në anglisht, ju mund të përjashtohen nga kërkesat e testit të gjuhës. Edhe qytetarët e vendeve të BE / EEA mund të bien nën këtë kategori.

Institucionet e arsimit të lartë përcaktojnë kërkesat e gjuhës në mënyrë të pavarur, kështu që është mirë në qoftë se ju kontrolloni kushtet e sakta dhe rregullat direkt nga faqet e institucioneve përkatëse.

Vini re se sidoqë të jetë para se të aplikoni në ndonjë institucion duhet plotësuar kushtet e plota të gjuhës angleze pra institucionet finlandeze nuk lejojnë që arritjen e nivelit të gjuhës ta bëni ndërkohë dmth ata nuk ofrojnë kushte që studentet njëherë të mësojnë gjuhën e pastaj të studiojnë prandaj ata këshillojnë që testet e gjuhës ti bëni në vendin tuaj nga shkollat që janë të pranuar zyrtarisht.

Gjuha finlandeze nuk është e detyrueshme të dini nëse aplikoni në programet ku zbatohet gjuha angleze por sidoqë të jetë ata sugjerojnë që se paku ti mësoni bazat elementare që t'ju ndihmojnë për nevojat e ndryshme gjatë studimeve.

Nëse dëshironi të aplikoni në programet ku zbatohet gjuha finlandeze apo suedeze atëherë duhet ta flisni rrjedhshëm gjuhën finlandeze.

Vlerësimi i diplomës

Kopjet e certifikatave dhe diplomës

Kudo që të aplikoni dhe në të gjitha nivelet si Bachelor, Master apo Doktoraturë ju duhet që se bashku me aplikacionin ti bashkangjitni edhe kopjet e certifikatave, diplomave apo kualifikimeve që i keni bërë më parë. Të gjitha këto dokumente duhet të jenë zyrtare nga shteti që vini.

Ju lutem gjithmonë kontrolloni saktësisht informacionet të leshuara nga institucionet përkatëse pasi që aty do gjeni të gjitha informacionet e nevojshme se ku dhe kur duhet dërguar dokumentet e kërkuara.

Vlerësimi i diplomës bëhet nga institucioni i arsimit të lartë finlandez që ka pranuar aplikacionin tuaj.

Keni kujdes për ata të cilët vijn me jetu në Finland dhe dëshirojn që ta bëjn diplomën e vlefshme apo verifikimin, jan disa procedura tjera të cilat i shqyrton ministria e edukimit por për këto më gjerësisht do gjeni informacionet tek seksioni "Lejëti".

Disa pika të rëndësishme për diplomat dhe çertifikatat

- Ju lutëm mos dergoni dokumentet tuaja tek zyra e pranimit para se të kërkohet nga ata dhe keni kujdes se dokumentet përmes postës elektronike (e-mail), Fax apo të skanuara nuk pranohen.
- Zakonisht ju duhet ti dërgoni kopjet e dokumenteve origjinale të vërtetuara zyrtarisht përmes adresës postare pasi ta keni përfunduar formularin online në internet.
- Kopjeve të dokumenteve duhet ti bashkangjitni edhe përkthimet zyrtare në ndonjërin nga këto gjuhë, Anglisht, Finlandisht apo Suedisht, nëse dokumentet tuaja origjinale janë në ndonjë gjuhë tjetër.
- Ju rekomandohet që të gjitha dokumentet ti dërgona së bashku në një vend, që procedura e aplikacionit tuaj të jetë ma e lehtë.
- Ju lutem, respektoni orarin që kërkohet ti dërgoni dokumentet sepse nëse dërgohen me vonesë, aplikacioni juaj nuk mirret në shqyrtim.
- Ndonjëher duhet ti tregoni edhe dokumentet origjinale nëse kërkohet.
- Institucionet e arsimit të larë finlandez janë shumë të rrept për dokumentet e falsifikuara dhe nëse keni të përfshirë ndonjë informacion të rremë në aplikacionin tuaj atëherë ju do të diskualifikoheni.

Provimet pranuese

Një tipar i rëndësishëm i zgjedhjes së studentëve

Është praktikë e zakonshme në arsimin e lartë finlandez të ketë provim pranues. Aplikantët finlandez i nënshtrohen provimit pranues pas shkollës së mesme nëse dëshirojn të studiojn në shkolla politeknike apo universitete.

Edhe studentët e huaj duhet ti nënshtrohen provimit pranues, zakonisht në nivelin Bachelor ndërsa për nivelin Master tek shumica përzgjedhja bëhet në bazë të meritave nga studimet e mëparshme Bachelor por në disa programe siq janë artet pamore, dramë apo programet e muzikës kërkohet provim pranues.

Forma më e zakonshme për një provim pranues është një test me shkrim, por kur aplikojnë për lëndë si artet pamore, dramë, apo muzikë, ju keni nevojë për të përgatitur një referenc të punës tuaj, ose mund të ju thërrasin për një provë.

Në shumicën e rasteve, provimet pranuese mbahen në Finlandë, dhe aplikantët që janë të ftuar në provim pranues duhet të udhëtojnë personalisht në Finlandë për ti nënshtrohur provimit (rreth qeshtëjës së Vizës lexoni tek seksioni Lejëti).

Në shkollat politeknike dhe universitetet e shkencave të aplikuara, shtetët të cilat bëjnë pjesë në rrjetin FINNIPS – www.finnips.fi mund ta bëjnë provimin pranues edhe në vëndin e tyre ndërsa nëse aplikoni në universitete ju duhet të kontaktoni direkt universitetin dhe shikoni nëse është e mundur të mbani provimin pranues në vëndin tuaj.

Kompletimi i suksesshëm i provimit pranues, sa herë që kërkohet, është pjesë thembësore në përzgjedhjen e studentëve pra nëse pranoni një ftesë për provimin pranues, përgatituni mirë për testin në përputhje me udhëzimet e siguruar nga zyra e pranimit.

Mos harroni se edhe në qoftë se çertifikatat e shkollës janë deri në standardet e kërkuar, ju nuk mund ta merreni një vend studimi nëse rezultati juaj në provim nuk kalon poenat e kërkuar.

Përzgjedhja e studentëve

Çfarë ndodh pas periudhës së aplikimit?

Pasi të mbyllet periudha e aplikimit, institucionet e arsimit të lartë fillojnë përpunimin e aplikacioneve. Vetëm kandidatët të cilët kanë paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara brenda periudhës së caktuar mirren në konsideratë gjatë procesit të përzgjedhjes së studentëve.

Për shkak numrit të madhë të aplikacioneve hyrëse, procesi i përzgjedhjes mund të marrë pakë kohë pra të jeni pak të durueshëm. Ju mund ti gjeni informacionet rreth informimit tek webfaqja e pranimit të aplikacioneve.

Më lartë e cekem se nëse keni aplikuar për studime të nivelit Bachelor, në disa raste niveli Master apo programe të caktuara, ju mund të keni nevojë për të marrë pjesë në një provim pranues para se vendimi përfundimtar të jetë bërë.

Një proces konkurrues

Ka vetëm një numër të kufizuar të vendeve në të gjitha programet për çdo vit prandaj procedura e zgjedhjes së studentëve mund të jetë mjaft konkurruese, dhe ndonjëherë edhe kandidatët e mirë nuk gjenden në mesin e të pranuarve. Kjo megjithatë nuk duhet të ju dekurajoj nga aplikimi sepse është diçka që çdo aplikant duhet të jetë i vetëdijshëm rreth konkurrencës. Dhe siq e ceka edhe më lartë është gjithmonë pozitive nëse ju aplikoni në 3 vende të ndryshme pasi që procedura mund të jetë pothuajse e njëjtë.

Nëse jeni pranuar

Institucionet në fund ju dërgojë letrat e pranimit studentëve të cilët janë pranuar. Mos harroni të konfirmoni pjesmarrjen përfundimtare nëse ju kërkohet. Pastaj ju mund të filloni organizimin e çështjeve praktike të jetës tuaj të studimeve në Finlandë. Ju lutem rreth lejeqëndrimit (vizës) lexoni tek seksioni "Lejë – studentët".

Jeta në Finland

Para se të arrini, disa gjërat thelbësore

Pasi të keni fituar një vend studimi në Finlandë, qoftë për shkëmbime akademike, një program i plotë studimi, apo një periudhë kërkimore, janë disa gjëra praktike që ju nevojiten ti bëni si parapërgatitje që plani juaj të funksionoj më mirë.

Para së gjithash, ju lutem sigurohuni që ju keni një plan realist në lidhje me financimin e periudhës së studimit tuaj në Finlandë. Kjo është shumë e rëndësishme, jo vetëm për shkak të kërkesës financiare në lidhje me lejen e qëndrimit tuaj studentor, por edhe për vetë sigurinë tuaj financiare. Disa programe të nivelit Master mund të përfshijnë një tarifë vjetore shkollimi për studentët që nuk janë nga vendet e EU/EEA. Por edhe në qoftë se studimet tuaja në Finlandë janë pa pagesë, ju duhet për të mbuluar shpenzimet tuaja të përditshme për nevojat jetësore.

Përveç kësaj, ju duhet të keni në konsideratë të paktën gjërat në vijim:

- Viza / leje qëndrimi
- Sigurimi
- Rregullimi i udhëtimit
- Akomodimi juaj studentor në Finlandë

Mos harroni të rezervoni kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjitha formalitetet e nevojshme si marrja e pasaportës, rregullimi i vizës (leja e qëndrimit tuaj) dhe sigurimin.

Pasi të keni arritur

Duhet ta dini se edhe pasi të keni arritur në Finland, që në fillim ju keni për detyrë ti kryeni disa obligime të cilat po i shënojmë më posht:

- Regjistrimi në institucionin e arsimit të lartë
- Detajet rreth akomodimit tuaj studentor
- Regjistrimi i qëndrimit tuaj në Finlandë, mund ta bëni në Polici ose në zyrën lokale të regjistrimit - Maistraatti www.maistraatti.fi (nëse qëndroni për të paktën një vit të plotë)
- Regjistrimi i çështjes së tatimit (nëse planifikoni të punoni ka pak gjatë studimeve)
- Gjëra tjera praktike në jetën e përditshme (llogari bankare, nr. telefoni, transporti lokal, etj)

Zakonisht, pas mbërritjes tuaj ju mund të kërkonti ndihmë në këto mënyra të lartë dhe çështje të tjera praktike nga institucioni juaj mikëpritës ose unioni studentor. Nëse keni ndonjë pyetje ose jeni në dyshim në lidhje me disa çështje praktike rreth jetës tuaj studentore në Finlandë ju lutem mos ngurroni të kërkonti ndihmë nga zyra ndërkombëtare e universitetit tuaj finlandez, unionit studentor apo pyetni ndonjë student. Të gjitha këto institucione dhe gjithashtu studentët finlandez janë shumë të sjellshëm që t'ju tregojnë gjërat për të cilat ju keni nevojë.

Kostoja e jetesës

Sa para do të duhet?

Në Finlandë, kostoja e përgjithshme e jetesës është relativisht e lartë, por ende përafërsisht e njëjtë si në vendet tjera të BE-së.

Kur aplikoni për lejë qëndrimi (vizë studentore), studentët ndërkombëtare duhet të tregojnë se kanë të paktën 500 € në muaj (6000 € në vit) në dispozicion të tyre. Edh kur ta bëni vazhdimin e vizës ju duhet të dëshmoni se keni para të mjaftueshme për vitin në vijim. Ju lutemi lexoni me kujdes tek "lejet e qëndrimit" për informacionet mbi kërkesat financiare të paraqitura nga autoritetet e emigracionit.

Shpenzimet mesatare mujore të jetesës për një student në Finlandë janë rreth 700-900 €. Kjo mund të ndryshojë pak, në varësi të vendndodhjes tuaj, për shembull, strehimi dhe shpenzimet e tjera të jetesës mund të jetë më të larta në zonën metropolitane të Helsinkit dhe qytete të tjera të mëdha.

Si student ju mund të merrni zbritje në vende të ndryshme si psh në restorante dhe kafeteri studentore, transporti publik, pishina etj. Gjithashtu, banimi në konvikte është pakës më i lirë dhe për këtë ju rekomandojmë që ta kontaktoni institucionin ku studioni për informacione më të sakta.

Shpenzimet e jetës mund të mvaren edhe nga ju se sa kurseni apo sa shpenzoni për kohë të lirë por në disa raste duhet të keni parasysh se disa tarifa të vogla duhet ti paguani e si shembull më herët përmendëm tarifen për studime Master e cila mund të jetë pjesë që duhet paguar.

Disa shpenzime gjatë studimeve ju mund ti mbuloni edhe duke punuar me orar të shkurtër por gjithmonë duhet të keni parasysh se ju nuk mund të bazoheni se shpenzimet e jetës studentore do mvaren nga puna që mund ta bëni sepse ndonjëherë është vështirë të gjeni një vënd të punës duke marrur parasysh shumë kushte që një student i ri nuk mund ti plotësojë si psh gjuha, përvoja etj.

Nga përvoja ime personale do mundohem ti jap disa këshilla të cilat besoj se mund të jenë të dobishme në rast se keni nevojë ti shfrytëzoni. Siq thash më lartë disa faktor që mund të ndikojnë në mos gjetjen e një vendi të punës janë gjuha, përvoja, njohja e rrethit etj, por kjo nuk do të thotë se gjërat janë të kufizuara dhe nuk ka rrugë tjera sepse Finlanda ka një sistem i cili funksionon shumë mirë në këto fusha prandaj ju duhet ti shfrytëzoni këto mundësi në lehtësimin e jetës tuaj studentore.

Sistemi i punësimit në Finland zakonisht mvaret nga monopoli i ndërmarrjeve të mëdha dhe ekzistojnë disa forma të kontratave për punësim prandaj pasi ju jeni si student do mundohem të jap një rrugë më të lehtë në zgjidhjen e kësaj çështje.

Janë disa ndërmarrje të mëdha të cilat marrin edhe puntor të huaj që nuk flasin gjuhën finlandeze por së paku duhet të dini gjuhën angleze dhe duke marrur parasysh statusin tuaj si student ju duhet të flisni gjuhën angleze prandaj edhe mundësit janë të hapura. Studentët zakonisht punojnë gjatë fundjavës dhe pikërisht këto ndërmarrje janë të përshtatshme për ju pasi që puna të cilën duhet ta bëni mvaret nga dëshira juaj pra konkretisht në kontratën që ju do e bëni me ndërmarrjen do t'ju sqarohen të gjitha udhëzimet dhe kushtet e kontratës në gjuhën angleze dhe unë më posht po mundohem ti përshkruaj disa pika kryesore:

- Së pari duhet ta dini se ju jeni një puntor me qira pra punën që do e bëni do ja u gjej ndërmarrja që ju keni bërë kontratë ndërsa punën konkrete e bëni për një ndërmarrje tjetër.
- Orari i punës mvaret në bazë të nevojës së klientit (ndërmarrjes ku do e bëni punën).
- Ju nuk jeni të detyruar që të shkoni në punë patjetër nëse nuk keni kohë apo për ndonjë arsye nuk doni të shkoni sepse në bazë të kontratës punëdhënsi juaj duhet të ju pyes juve nëse doni të punoni por nëse ju pranoni me shku për atë ditë atëherë ju jeni të detyruar që të shkoni në punë.
- Në rast se ju keni rezervu ma herët që të shkoni të punoni dhe ndodhë që për shkaqe shëndetsore apo tjera nuk mund të shkoni ju duhet ti lajmroni me kohë punëdhënsit (në rast se jeni sëmur dhe merreni vërtetim nga mjeku, orari i punës ju paguhet)
- Vendi i punës mund të jetë i ndryshëm psh një ditë mund të punoni në hotel, ditën tjetër në ndonjë kafiteri etj por edhe këtu ju mund të vëndosni se çka doni të punoni
- Nëse punoni gjat natës (24-06), do përfitoni edhe disa shtesa (punëdhënsi ju njofton)
- Nëse punoni gjatë festave kur është pushim ose të dielave, pagesa bëhet dyfish
- Shumica e ndërmarrjeve orarin e punës e ofrojnë edhe online në internet pra mund ta zgjidheni vetë se a doni me punu dhe kur (kuptohet nëse ka vende të lira)

Keni parasysh se këto rregulla nuk vlejnë për të gjitha ndërmarrjet sepse unë këtu e morra shembullin vetëm tek ndërmarrjet që marrin puntor me qira dhe në të vërtetë kjo është rruga ma e lehtë për të huajt për tu inkuadruar në sistemin e punës në Finlandë ndërsa pas disa viteve ju do e shihni vetë se si funksionojnë gjërat tjera.

Më posht do jap disa adresa të ndërmarrjeve më të mëdha që ofrojnë punë me qira:

HR House www.hrhouse.fi

Staffpoint www.staffpoint.fi

Opteam www.opteam.fi

SOL www.sol.fi

ISS www.iss.fi

Barona www.barona.fi

VMP www.vmp.fi

Përveq këtyre nëse dëshironi të kërkontë punë përmes zyrës së punësimit, mund ta bëni përmes internetit tek faqja zyrtare www.mol.fi.

Për këtë nëse dëshironi ti shikoni udhëzimet në gjuhën shqipe, shkoni tek projekti ynë në seksionin "Puna" dhe mund ta shikoni broshurën "Si të kërkohet punë në zyrën e punësimit".

Ka edhe shumë informacione tjera që mund ti bashkangjit me këtë broshurë por besoj se kjo që kam bërë deri më tani do të jetë e mjaftueshme sa për fillim dhe shpresoj se përveq këtyre materialeve ju do keni mundësi të merreni informacione edhe nga lidhjet e faqeve të cilat i kam vendosur sipas nevojës.

Përveq kësaj broshure ne kohë pas kohe publikojm broshura të ndryshme në projektin Emigranti duke u munduar ti plotsojm të gjitha fushat e jetës për nevojat e bashkëatdhetarëve tonë prandaj rrini në qasje me projektin tonë sepse ne punojm për ju.

Nëse keni ndonjë pyetje, ju lutëm mos hezitoni të na kontaktoni.

Lidhje të rëndësishme

Study in Finland

www.studyinfinland.fi

Centre for International Mobility

www.cimo.fi

UAF – University Admissions Finland

www.universityadmissions.fi

Online Applicants to Polytechnics in Finland

www.admissions.fi

Ministry of Education and Culture

www.minedu.fi

Finnish National Board of Education

www.oph.fi

Academy of Finland

www.aka.fi

Gjiganti www.gjiganti.com

Embassy of Finland in Pristina www.finlandkosovo.org

Burimet e materialeve

Study in Finland

www.studyinfinland.fi

Autor:

Faton Krasniqi